



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 62/16
Prishtinë, më 21.6.2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Shqipe Pantina dhe Fikrim Damka.

Munguan: Jelena Bontić, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta, Bali Muharremi dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza - Guvernator i BQK-së dhe Avdullah Hoti - Ministër i Financave.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Mentor Hyseni nga GIZ, Agnesa Haxhiu - monitoruese në KDI, Gentiana Hasani - gazetare, Albana Mavraj – gazetare nga Epoka e Re, Arta Rexha – gazetare nga Rrokum TV.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Isein, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 1.6.2016 dhe 8.6.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-100 për Ndihmën Shtetërore;
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 17.5.2016, 19.5.2016 dhe 24.5.2016

Kryetari – konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 17.5.2016, 19.5.2016 dhe 24.5.2016, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari - në bazë të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 28.1, brenda gjashtë muajve pas mbylljes së vitit financiar, BQK-ja duhet t'i dorëzoj Kuvendit raportin e aprovuar nga Bordi i Bankës. Raporti duhet të përmbajë: parashikimet mbi gjendjen e ekonomisë të vitit në vijim, arritjen e objektivave të politikave të saj dhe gjendjen e sistemit financiar të Kosovës.

Bedri Hamza - Raporti vjetor i BQK-së është përgatitur në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Raporti është miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore dhe i është dorëzuar Kuvendit. Gjatë vitit 2015, BQK ka realizuar me sukses aktivitetet e saja, në ruajtjen e një sistem financiar të qëndrueshëm, ka ofruar shërbime për autoritetet publike, institucionet përkatëse dhe publikun. Kontribut dha rikuperimi i ekonomisë në euzonë, e cila shënoj rritje prej 1.6%, gjë që rezultojë me sukses në ekonomitë e vendeve të rajonit dhe ballkanit. Deflacioni ishte i pranishëm, por pati masa të lehtësimit. Ekonomia e Kosovës sipas vlerësimeve BQK-së u rrit për 3.5% deri 4.0% të BPV-së, rritje kjo e bazuar në investimet dhe konsumin privat, pastaj rritja e remitencave, ndikimi i rritjes pagave në sektorin publik e të tjera ndikuan në rritje të të ardhurave të ekonomisë kombëtare. Dallimi eksport-import rezultojë me deficit tregtar 2.3 miliard euro, që ndikon në llogarinë rrjedhëse dhe kapitale në shumën totale prej 508.1 milionë euro. Remitencat u rritën për 8.5% apo 752,4 milion euro, ndërkaq vlera e Investimeve të Huaja Direkte ishte 324.4 milion euro (nga 152.1 milion euro sa ishte në vitin 2014), rritja më e lartë u evidentua në paluajtshmëri 58%. Pozita fiskale është e kënaqshme, deficitin buxhetor përfundoi brenda rregullës fiskal prej - 1.3% të BPV-së. Borxhi publik është rreth 13% të BPV-së. Niveli i çmimeve mbështetet në tregjet ndërkombëtare, në vitin 2015 pati deflacion 0.5%, si pasojë e çmimeve të mallrave, produkteve e shërbimeve të importuara, rënia e çmimeve ka rritur aftësinë blerëse të konsumatorit.

Vlera e asetëve financiare ishte 4.9 miliard euro, kreditë u rritën si rrjedhojë e kushteve të kreditimit dhe vlera e tyre është 2 miliard euro apo 7.3%, për dallim prej 2.4% sa ishte në vitin 2014. Normat e interesit në kredi u zvogëluan në nivelin e vendeve të rajonit me 7.7%, për dallim prej 9.3% sa ishte në vitin 2014 dhe rënia e kësaj norme u evidentua edhe te sektori i bujqësisë. Kurse depozitat shënuan normën mesatare prej 1.2%, nga 1.1% sa ishin në vitin 2014. Norma e kredive joperformuese ishte 6.2% për dallim prej 8.3% sa ishte në vitin 2014. Sektori bankar përfaqësohet me likuditet të lartë prej 45%, dhe është i kapitalizuar me normë prej 19%. Sa i përket sektorit të sigurimeve, ka humbje prej 7.7 milionë euro. Lidhur me parashikimet makroekonomike që bënë BQK, rritja ekonomike për vitin 2016 pritet të jetë prej 3.7% deri në 4%.

Aktivitetet kryesore të BQK-së ishin harmonizimi i ligjislacionit me standardet evropiane, kontributi në hartimin e ligjit për sigurimet, hyrja në fuqi e rregullorës për shqyrtim të ankesave, u licencua edhe një bankë duke shkuar numri në 10 të tilla, rritja e siguruesve duke u rritur numri në 15 kompani të tilla. U realizuan ekzaminime të rëndësishme financiare, me metodologjinë e bazuar në risk, u gjetën edhe shkelje për të cilat u ndërmorrën masa dhe vendime nga BQK-ja. BQK-ja ka vazhduar të ofroj shërbime cilësore për publikun, të siguroj një sistem efikas të pagesave, duke i respektuar standardet dhe parimet në tërësi, kemi ndërtuar sisteme të qëndrueshme efikase te kontrollit të brendshëm, si dhe të zhvillojmë bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare financiare, si me FMN, BERZH, GIZ, USAID, etj. Raporti përfshin edhe pasqyrat financiare të audituara, të cilat sipas auditorit shpalosin drejtë gjendje reale dhe materiale të BQK-së.

Safete Hadërgjonaj – theksoi se raporti është i detalizuar dhe nga të dhënat e prezantuar në raport shihet se ka performancë pozitive në çdo sektor. Kreditë joperformuese janë zvogëluar në 6.2%, krahasuar me vitin 2014, që ishin 8.3%. Nga raporti vërejmë se është rritur vlera e investimeve të huaja direkte gjë që është pozitive dhe duhet vlerësuar. Ndërsa, sektori i sigurimeve regjistrojë humbje prej 7.7 milion euro, krahasuar me vitin paraprak që ishte 2.5 milion euro, dhe për këtë është e nevojshme të kemi një sqarim? Mungesa së ligjit për institucionet mikrofinanciare apo e vështëron mbikëqyrjen e

punës së këtyre institucioneve, meqenëse po shohim se ky sektor ka realizuar profit më të lartë në vitin 2015 që ka arritur vlerën 2.5 milionë euro, dukshëm më e lartë se vitin e kaluar? Çështje tjetër është borxhi publik, i cili nuk është shumë i lartë në krahasim me vendet tjera, mirëpo ajo që më intereson është fakti se borxhi i brendshëm është më i lartë se borxhi i jashtëm. Si e shpjegoni këtë?

Bedri Hamza – në përgjigje të pyetjeve të parafolëses, sqaroi se sa i përket humbjeve të realizuara nga sektori i sigurimeve kjo vjen si rezultat i vendimit që është marrë për reduktimin e çmimeve të polisave kufitare për 50% dhe për qytetarët pati rezultat pozitiv, kurse për kompanitë rezultat negativ. Në të njëjtën kohë në mbështetjen e sektorit të sigurime, BQK ka ofrua tri alternativa: e para që kompanitë e sigurimeve të dalin me produkte të reja në treg dhe si rrjedhojë të rrisin të hyrat, e dyta racionalizimi i shpenzimeve të tyre, dhe e treta shtimi i kapitalit të tyre. Përndryshe nëse nuk iu përmbahen kriterëve dhe kushteve ligjore, BQK është e detyruar të shkojë në procedurat likuiduese, por ne nuk e dëshirojmë që të vie deri te një situatë të tillë. Sa i përket ligjit për institucionet mikrofinanciare është çështje e rregullimit të statutit të tyre, BQK asnjë institucion nuk e ka licencuar të tillë nëse nuk është shoqëri aksionare. Borxhi publik është më i ulëti në rajon, nuk paraqet rrezik të madh makrofiksal, borxhi i brendshëm është më i madh se borxhi i jashtëm, për shkak të normave shumë të mira të interesit në tregun e brendshëm të letrave me vlerë.

Shqipe Pantina - theksoi se puna e BQK-së dhe raporti nuk duhet të shihet si e izoluar, por se sa të dhënat dhe aktivitetet e prezantuara kanë ndikuar në zhvillimin ekonomik. Remitencat janë të larta, por ato do të duhej të ishin në investime, sepse shumica e këtyre remitencave shkojnë në konsum dhe patundëshmëri, ku nuk ka një qarkullim të brendshëm më të madh, që do të ndikonte në investime direkte në ndërmarrje, bujqësi apo të ngjashme. Sa i përket kredive, 51% e tyre shkojnë në tregti dhe një numër i vogël i tyre në bujqësi, që është shqetësuese, pasi që kjo formë nuk stimulon rritjen ekonomike. Përkundër faktit që bankat i kanë ulur kamatat, në anën tjetër i kanë rritur çmimet e produkteve dhe shërbimeve të tyre dhe kjo është një llojë kamuflimi kamator. Shqetësuese është fakti i deficitit të lartë tregtar gjë që tregojnë shifrat e nivelit të importit krahasuar me eksportin.

Një problematikë shqetësuese paraqet edhe veprimtaria e institucioneve mikrofinanciare. I gjithë koncepti i mikrofinancave është që të ndihmojnë të varfërit, ata që nuk kanë qasje në bankat e rregullta, ndëkaq normat mastare të interesit të kredive që lëshojnë këto institucione janë rritur. Prandaj, ky është sektor që ka nevojë për hetime më të mëdha, pasi që këtu ka ndodhur krimi më i madh i organizuar financiar. Sektori financiar është stabil, por nuk po jep rezultate në thithjen e investimeve të huaja. Sa i përket mjeteve të fondit pensional, rreth 95% janë investuar jashtë vendit, ndërsa vetëm 5 % brenda vendit dhe do të duhej që këto mjetet të investoheshin më shumë brenda vendit? Sa i përket çështjes së bankave, na jepni më shumë sqarime për bankat që i quani si degë të bankave të huaja?

Bedri Hamza – sqaroi se çështja e remitencave është pozitive, janë para private të qytetarëve, prandaj është vështirë me u kanalizue dhe me u përkthi në investime. Për investimet e huaja direkte, Kosova ka nevojë, sepse e rrit qëndrueshmërinë ekonomike, dëshira jonë është që të ketë kapacitete më të mëdha prodhuese. Sa i përket kamatave, ato kanë rënë shumë, për një periudhë të shkurtër ka zvogelim për 50%, që ndihmon ekonomitë familjare dhe subjektet juridike. Ne kemi rritur licencat për subjekte juridike që mund të merren me shërbime bankare. Fitimi i bankave vjen si rezultat i zvogëlimit të shpenzimeve, si pasojë e numrit të rritje së depozitave, uljes së normës së kredive joperformuese. Sa i përket për bankave, ato mund të regjistrohen si subjekte të varura apo degë të bankave të huaja, që duhet të kenë menaxhmentin, bordin për ta udhëhequr degën. Bankat duhet të jenë subjekte të varura, sepse ashtu mund t'i kontrollojmë me lehtë edhe të ruajmë konkurrencën.

Kryetari – propozojë që komisioni ti rekomandojë Kuvendit miratimin e Raporti vjetor të BQK-së për vitin 2015.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se komisioni me pesë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Kryetari – propozojë që komisioni duke u thirrur në nenin 29 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, ti rekomandojmë Kryesisë së Kuvendit, që të ftojë Guvernatorin e BQK-së, për paraqitjen në Kuvend, të Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015, me rastin e shqyrtimit të këtij raporti në Kuvend.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit, që në bazë të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ftojë Guvernatorin e BQK-së, për paraqitjen në Kuvend, të Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2015, me rastin e shqyrtimit të këtij raporti në Kuvend.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.05/L-100 për Ndhmën Shtetërore

Avdullah Hoti - sqaroi se ndryshimet kryesore në këtë projektligj, për dallim nga ligji në fuqi janë rreth përbërjes së Komisionit për Ndhmë Shtetërore, që kandidatët që do të zgjidhen duhet të jenë persona teknokrat dhe të pavarur, profesional, ndërkaq Zyra për Ndhmë Shtetërore, duhet të transferohet dhe të funksionojë si Departament brenda Ministrisë së Financave. Ky ligji duhet të jetë medoemos i harmonizuar me ligjet e Bashkimit Evropian.

Pas sqarimeve dhe propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr.05/L-100 për Ndhmën Shtetërore.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015

Kryetari - propozojë që pika e pestë e rendit të ditës të shtyhet për shqyrtim për një mbledhje tjetër të komisionit.

Në bazë të propozimit të kryetarit, Komisioni pikën e pestë të rendit të ditës: Shqyrtimin e Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2015, e shtyu për shqyrtim në një mbledhje tjetër të komisionit.

6. Të ndryshme

Kryetari – njoftoi se me ftesë të Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, tregëti dhe industri, kam marrë pjesë në takimin e këtij komisioni, ku është shqyrtuar dhe votuar amendamenti 32 që ka të bëjë me ndryshimin e nenit 22 të Projektligjit nr.05/L-079 për Investimet Strategjike, materialin të cilin e

keni përpara. Siç e dijmë vendimi i Kuvendit është që komisioni ynë edhe komisioni funksional të harmonizojnë qendrimet lidhur me këtë amendament. Komisioni funksional e riformuluar amendamentin 32 dhe propozojë që të përkrahim këtë amendament, sipas tekstit që keni përpara dhe në seancë të dalim me qëndrime të harmonizuar si dy komisione.

Pas sqarimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se Komisioni me pesë vota Për, asnjë Kundër dhe asnjë Abstenim, përkrahu amendamentin 32 të Komisionit funksional për zhvillim ekonomik, tregti dhe industri, lidhur me ndryshimin e nenit 32 të Projektligjit nr.05/L-079 për Investimet Strategjike, si në vijim:

Amendamenti 32

Neni 22, ndryshohet si vijon:

Neni 22

Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së palujatshme publike dhe shoqërore tek investitori i interesuar

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të palujtshme shoqërore për investime strategjike në bazë të Ligjit për shpronësimin e pronës së palujtshme, vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë vendim me shumicë të thjeshtë votash.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të palujtshme publike, përkatësisht komunale për investime strategjike vetëm pas vendimit me shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht Kuvendit të Komunës përkatëse.

Mbledhja përfundoi në ora 12:10

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani